

KRONIKA SHKENCORE

Nga Kongresi Ndërkombëtar mbi Arbëreshët

KONTRIBUTE TË RËNDËSISHME SHKENCORE

Në Universitetin e Manhajmit të Republikës Federale të Gjermanisë u mbajt Kongresi ndërkombëtar për gjuhën, historinë dhe për kulturën e arbëreshëve të Italisë gjatë 25 e 26 qershorit të këtij viti. Në këtë Kongres shkencor morën pjesë rreth tridhjetë dijetarë të ndryshëm nga Italia, Gjermania Perëndimore, Jugosllavia, Bashkimi Sorjetik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Greqia dhe nga Polonia. Në Programin e Kongresit ishin të radhitura edhe kumtesat e filologëve të RPS të Shqipërisë dhe të RD të Gjermanisë, porse autorët e tyre nuk qenë prezentë.

Iniciator dhe organizator i këtij Kongresi ishte kryesisht romanisti i njohur i Seminarit të Romantikës të Universitetit të Manhajmit prof. dr. Rupprecht Rohr, i cili e mbajti fjalën e hapjes së Kongresit me ç'rast foli për rëndësinë e studimeve albanologjike dhe për gjuhën, historinë e kulturën e arbëreshëve të Italisë. Me këtë rast Kongresin e përshëndeti edhe Rektori i Universitetit të Manhajmit, prof. dr. Heinrich Chantraine.

Siç dihet, në 60 a 70 vendbanime të Italisë, veçanërisht në Kalabri, Apuli dhe në Sicili jetojnë arbëreshët, sikundër quhen shqiptarët e Italisë, edhe në ditët tona. Sipas shënimeve të reja numri i tyre arrin rreth njëqind mijë banorë, të cilët flasin shqip dhe po aq të cilët gjuhën e tyre amtare e kanë zëvendësuar me të tjerë, kryesisht me italishten. Që të gjithë këta arbëreshë janë pasardhës të atyre arbëreshëve (shqiptarëve) të vjetër që shtegtuuan në Itali, duke u shpërngulur prej territoreve të Ballkanit, kryesisht të Shqipërisë dhe të Greqisë në fund të shekullit XV dhe gjatë shekullit XVI. Ata në përgjithësi e ruajnë gjuhën e vjetër dialektore, krijimtarinë poetike gojore, doket dhe ritet familjare, si dhe disa nga festat rituale të motmotit me kulturën e përgjithshme popullore shpirtërore dhe materiale, porse kultivojnë edhe letërsinë e shkruar, e cila gjithashtu e ka historikun e saj.

Kongresi në fjalë trajtoi disa çështje të fushave shkencore të lartpërmendura me anë të kumtesave dhe të diskutimeve të gjalla e të argumentuara të pjesëmarrësve. Në këtë mënyrë u ndriçuan shumë çështje të reja, u thelluan e u zgjeruan njohuritë për historinë, gjuhën, letërsinë popullore dhe të shkruar si dhe për kulturën e përgjithshme të arbëreshëve të Italisë të kohës së kaluar

si dhe për të sotmen. Pa dyshim, Kongresi dha impulse të reja për studimin e gjithanshëm të kësaj popullsie të veçantë kombëtare në Itali si dhe të grupeve të ngjashme nacionale analoge në botë.

Në fillim të Kongresit u paraqit kumtesa e prof. I. Parrino nga Palarmo „Autonomia administrative e arbëreshëve të Sicelisë dhe e zhvillimit kulturor dhe sociopolitik të arritura në shekujt XVIII e XIX”, me ç’rast u theksua krijimtaria e gjerë letrare e arbëreshëve. Diskutimi afirmativ vuri në pah sidomos pjesëmarrjen e gjerë të arbëreshëve të Sicelisë dhe të Kalabrisë në Revolucionin e Garibaldit. Në vazhdim, prof. G. Homeyer foli për detyrat e institucionit „Casa d’Europa in Rende” të Kozencës në Kalabrinë shumëgjuhëshe. Kumtesa dhe diskutimi përmtuan çështjet interesante të lidhjeve gjuhësore që kanë kalabrezët arbëreshë dhe italianë në komunikimin e përditshëm. Sa i përket gjuhës së folur dhe letrare shqipe, ky institucion bashkëpunon me Seminarin e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Universitetit të Kozencës. Ndërkaq, prof. A. V. Desnickaja nga Leningradi në kumtesën e saj u përqendrua në çështjen e folklorizmit në letërsinë italo-arbëreshë të shekullit XIX, me ç’rast ndriçoi fenomenin e interesimit të gjerë të arbëreshëve ndaj folklorit dhe ndikimit të tij të fuqishëm në këtë letërsi në atë kohë. Kumtesa dhe diskutimi gjithashtu i gjallë ndriçuan disa nga komponentet e dorës së parë të kësaj dukurie, siç janë anonimiteti dhe autorësia, mistifikimi, gjeneza sidomos e këngëve, duke përfshirë edhe çështjen e strukturave metrike-kompozicionale të këngëve popullore si dhe bartja e përpunimi i tyre në poema të shkruara nga autorët e njohur arbëreshë.

Prof. M. Camaj nga Universiteti i Mynhenit parashtroi gjithashtu kumtesën interesante „Kontinuiteti i motiveve të vjetra të trashëguara në letërsinë e arbëreshëve”, me ç’rast me shembuj konkretë këtë kontinuitet e tregoi me motivet e bartura nga veptrat e shkrimtarëve tanë të vjetër — Marin Barleti, Pjetër Bogdani, Jul Variboba etj., në letërsinë e arbëreshëve, sidomos në vepat e De Radës. Kjo kumtesë serioze me gjithë diskutimin që u zhvillua theksuan nevojën e studimit të këtyre dhe të lidhjeve të tjera midis letërsisë sonë të vjetër dhe të periudhave të mëvonshme deri më sot, meqenëse kjo çështje kërkon ndriçime më të gjera dhe të shumanshme. Nga po ky Universitet, prof. V. Broj paraqiti rezultatet e kërkimeve të tija mbi perfektin e të folmeve arbëreshë, duke vërejtur një dukuri interesante gjuhësore se trajta e kësaj kohe foljore ka kaluar nga funksioni kohor në funksionin modal të mënyrës habitore. Nga RF e Gjermanisë i parashtruan kumtesat e tyre edhe ty punonjëse shkencore: G. Birken (Manhajm) foli mbi kushtet e kuantitetit të vokaleve në dritën e materialeve të reja të së folmes së Horës së Arbëreshëve në Sicili; ntërsa E. Glaser (Bamberg) shqyrtoi strukturën e thesarit leksikor të së folmes arbëreshë të fshatit Frasnitë të rrethinave të Kozencës,

duke konstatuar se leksiku i kësaj së folmeje karakterizohet me fjalë autoktone shqipe dhe me fjalë të huazuara kryesisht nga italishtja.

Është e natyrshme që në këtë Kongres numri më i madh i pjesëmarrësve qenë dijetarët prej Italisë, prej të cilëve pesë arbëreshë, dy italian dhe një gjermane. F. Altimari nga Kozenca u bëri një vështrim analitik veprave të botuara në gjuhën gjermane mbi komunitetet arbëreshe të Italisë, e veçanërisht u ndal në studimet e G. Shtirit, të G. Majerit, të M. Lamercit, të A. Shmausit, të R. Rorit dhe të M. Camajt. Pastaj kolegu i tij I. Fortino mori në vëzhgim veprën „Kalimere” të Anton Santorit, dorëshkrimi i së cilës është ruajtur në Bibliotekën e Kopenhagës, të cilën e botoi autori i kësaj kumtese. Kumtesa dhe diskutimi konstatuan lidhjet e kësaj veprë të Santorit me këngët popullore rituale: me kalimet greke, me kolendrat, kullanat, me buzmin e shqiptarëve të Ballkanit si dhe me koledat sllave. Në vazhdim dy profesorë italianë të Universitetit të Kozencës G. Trebisacce dhe M. Bolognari, secili veç e veç, dhanë disa njoftime historike dhe pedagogjike lidhur me bashkësitë kombëtare të arbëreshëve të atjeshëm, të dhëna këto që i zgjeruan njohuritë e pjesëmarrësve të sesionit përkatës.

Arbëreshi A. Kostantino, duke jetuar për një kohë të gjatë në Gjermani, i ka hetuar disa dukuri gjuhësore e veçanërisht bilinguizmin e gasterbajterëve arbëneshë në Gjermani. Ai, ndër të tjera, në studimin e tij theksoi se arbëreshët e tillë në vend të shumë fjalëve të gjuhës së tyre amtare përdorin edhe fjalë gjermane e rrallëherë edhe italiane, kështu që leksiku i tyre në komunikimin e përditshëm është mjaft i përzier. Ndërkaq, punonjësi i ri shkencor arbëreshi G. Bellushio nga Kozenca i parashtroi rezultatet e vëzhgimeve mbi vokalet e të folmeve arbëreshe të Frasnitës, të Lungros e të San-Basiles. Përgjithësisht mund të thuhet se kontributet e arbëreshëve shënuan një hap të ri në studimet filologjike mbi arbëreshët e Italisë.

Nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në këtë Kongres morën pjesë me kumtesa profesorët E. Hemp dhe A. Pipa. I pari foli mbi arkaizmat e të folmeve arbëreshe duke u përqendruar në rikonstruktive të disa pjesëve të sistemit verbal të shqipes në krahasim me ato të të folmeve arbëreshe të Italisë dhe të Greqisë. Pjesëmarrësi i dytë i këtij vendi foli gjerësisht dhe veçmas për humanistët italo-arbëreshë.

Filologu i Athinës T. Johalas kumtoi punimin e tij me titull „Emrat dhe mbiemrat grekë në bashkësitë greko-shqiptare të Italisë”, në të cilin u përpoq të shpjegonte një varg antroponimesh të arbëreshëve të Italisë me prejardhje të gjuhës greke. Gjatë diskutimit lidhur me këtë kumtesë u shfaqën edhe vërejtje. Ndërkaq, I. Savicka nga Varshava për objekt trajtimi në kumtesën e saj

kishte fonetikën e ballkanizmave italo-shqiptare, duke bërë krahasime me veçoritë fonetike të arbënishtes e të shqipes letrare.

Universitetin e Kosovës e përfaqësuan në këtë Kongres profesorët Sh. Pllana me kumtesën „Kontributi i Jeronim de Radës në fushën e folklorit arbëresh” dhe L. Mulaku me punimin „Fjalëformimi në gjuhën e Lekë Matrëngës” — shkrimtarit të parë arbëresh.

Mendojmë se mbajtja e këtij Kongresi në Gjermani, ku studimet albanologjike kanë një traditë të mirë e të gjatë, shënon një hap shkencor të rëndësishëm. Si i tillë meriton përshëndetje dhe lavdërime, aq më tepër për arsye se me kumtesë të vlefshme dhe me diskutime me një tolerancë të plotë shkencore, u shqyrjuan me kompetencë shumë çështje gjuhësore, sidomos dialektore, letrare, folklorike, historike dhe kulturore të arbëreshëve të Italisë në kushte të caktuara dhe specifike. Vlen të shtohet se në disa kumtesa u përmendën edhe faktorët asimilues të gjuhës lokale të arbëreshëve në kushtet e caktuara në Itali. Mirëpo po ashtu u tha se bënë përpjekje të arbëreshëve për t'u bërë mësimi shkollor edhe në gjuhën shqipe në shkollat e vendbanimeve të arbëreshëve të atjeshëm. Gjithashtu në disa kumtesa u vu në pah aktiviteti i arbëreshëve për ruajtjen dhe kultivimin e traditave kulturore-folklorike kombëtare si dhe në krijimin e veprave të reja letrare, duke i përcjellë me studime të ndryshme.

Duke parë se materialet e këtij Kongresi janë shumë të vlefshme, Universiteti i Manhajmit do t'i publikojë në një botim të veçantë.

L. MULAKU E SH. PLLANA

Fakulteti Filozofik
Prishtinë